



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 190, Datë 12.08.2025

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENERGOVIA.ALBANIA” SH.P.K. NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, gërma “d”, dhe 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “e”, 5, pika 1, gërma “e”, 13 dhe 14, pika 9 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.08.2025, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1693/15 prot., datë 07.08.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “Energovia.Albania” sh.p.k për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 113, datë 03.06.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Energovia.Albania” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Njoftimi për fillimin e procedurës u botua në median e shkruar më datat 04.06.2025 dhe 05.06.2025, si dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s. Brenda afatit të përcaktuar për paraqitjen e komenteve apo objeksioneve (deri më 13.06.2025), nuk u paraqit asnjë koment.
- ERE, me shkresën nr. 1693/7 prot., datë 05.06.2025, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës së licencimit, si dhe i ka bërë me dije informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet për këtë aplikim. Kjo shkresë u kthye mbrapsht nga shërbimi postar, ndaj më 11.06.2025 iu dërgua shoqërisë nëpërmjet e-mailit një kopje e skanuar.
- Në përgjigje, me e-mailin e datës 20.06.2025, shoqëria depozitoi pjesërisht dokumentacionin e munguar, duke njoftuar se vërtetimin e gjendjes gjyqësore për administratorin do ta sillte sapo të pajisej me të dhe të përkthehej. Po atë ditë, ky dokumentacion u depozitua edhe fizikisht në protokollin e ERE-s me nr. 1693/9 prot., datë 20.06.2025.

- Për sa më sipër, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 136, datë 07.07.2025, është vendosur zgjatja e vendimmarrjes së bordit të ERE-s deri në 30 (tridhjetë) ditë për aplikimin e shoqërisë për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, duke i lënë detyrë shoqërisë që brenda 20 (njëzet) ditëve të depozitojë në ERE vërtetimin për gjendjen gjyqësore të administratorit të saj.
- ERE ka njoftuar shoqërinë për këtë vendimmarrje, me shkresën nr. 1693/11 prot., datë 09.07.2025, shkresë e cila është kthyer sërish mbrapsht nga shërbimi postar, ndaj i është dërguar shoqërisë një kopje e skanuar me e-mailin e datës 15.07.2025.
- Me e-mailin e datës 16.07.2025, protokolluar në ERE me nr. 1693/12 prot., datë 16.07.2025, shoqëria ka përditësuar adresën e saj dhe ka njoftuar për të depozituar brenda afatit dokumentin e munguar.
- Me e-mailin e datës 28.07.2025, protokolluar në ERE me nr. 1693/13 prot., datë 28.07.2025, dhe së fundi, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1691/14 prot., datë 04.08.2025, shoqëria ka depozituar në ERE-dëshminë e penalitetit të administratorit në format origjinal.

Përputhshmëria e Aplikimit me Rregulloren

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike në zbatim të Aneksit A të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar.
- Në referencë të përcaktimeve të Rregullores, aplikuesi ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; pikën 1.2, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”; pikën 1.3, gërmat “a”, “b” dhe “c”; si dhe pikën 2.5.
- Vlefshmëria kontratave të shërbimit për stafin teknik (shërbime ligjore dhe të kontabilitetit) nuk mbulon të gjithë afatin 5-vjeçar të licencës, ndaj brenda afatit të përfundimit të tyre, pra brenda datës 01.02.2026 shoqëria duhet që të depozitojë kontratat e rinovuara për shërbimet e jashtme, ose çdo dokument tjetër në lidhje me disponimin e stafit teknik.
- Në përfundim, vlerësohet se shoqëria ka përmbushur kushtet për licencim, me detyrimin për të zbatuar në vijim edhe kushtet e përcaktuara në këtë vendim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “Energovia.Albania” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Brenda datës 01.02.2026, shoqëria duhet të depozitojë kontratat e rinovuara për shërbimet e jashtme, ose çdo dokument tjetër në lidhje me disponimin e stafit teknik.
3. Ky vendim është objekt rishikimi në lidhje me plotësimin/mos plotësimin e pikës 2.
4. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “Energovia.Albania” sh.p.k., OST sh.a., OSSH sh.a. dhe ALPEX sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI